



Pranuar / Dorezuar Priljena / Prodato Received / Delivety	12. 04	2021	1	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	SKPMSTHCK	1724/2021		114



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.101/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.101/2021 të datës 25.02.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga "Bill Clinton", 38 A 2/2, në Prishtinë, kundër vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020, respektivisht kundër organit të punësimit-Agjencia e Regjistrimit Civil/Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve të punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 12.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.101/2021 e datës 25.02.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. Anullohet Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2020 i datës 01.02.2021 për ankuesin.
- III. Detyrohet Udhëheqësi i Sektorit për Pranimin dhe Verifikimin e të Dhënave, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh, duke bërë rivlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi Zyrtar i Lartë për Hulumtim pran Departamentit për Prodhimin e Dokumenteve në Agjencinë e Regjistrimit Civil, me datë 25.02.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 826/2021 të regjistruar me numër A.nr.101/2021 në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, me datë 01.03.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa me datë 05.03.2021 ka pranuar përgjigje në ankesë se bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me numër protokollit 826/2011 të datës 25.02.2011; Akt Emërimit e datës 04.04.2013 të ankuesit; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 01.02.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 22.01.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 27.12.2018; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën "Zyrtar i Lartë për hulumtime" i datës 26.05.2015; E-mailin e datës 04.03.2021, 11.01.2021; E-mailin e datës 08.01.2021; E-mailin e datës 30.12.2020; Kërkesë për prova shtesë e datës 19.03.2021; E-mailin e datës 19.03.2021 nga

Organogramin e Agjencisë së Regjistrimit Civil; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punës për Zyrtaren e Lartë të Verifikimit datë 03.02.2021; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punës për Operatore për letërnjoftime datë 01.02.2021; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punës për Operatore për Pasaporta datë 01.02.2021; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punës për Operatore për patentë shoferë datë 22.01.2021; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punës për "Udhëheqësi i Sektorit për Pranimin dhe Verifikimin e të Dhënave" datë 01.02.2021;

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, ***është e bazuar, sepse:***

Bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Akt Emërimit e datës 04.04.2013 është konstatuar se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Hulumtim në kuadër të Departamentit për Prodhimin e Dokumenteve në Agjencinë e Regjistrimit Civil.

Udhëheqësi i Sektorit për Pranimin dhe Verifikimin e të Dhënave në Agjencinë e Regjistrimit Civil, në cilësinë e udhëheqësit të drejtpërdrejtë të ankuesit, me datë 01.02.2021 ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020, për ankuesin, duke vlerësuar të njëjtin me notë të përgjithshme mjaftueshëm (2).

Ankuesi, kundër vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020, me datë 25.02.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë në fillim të vitit nuk i ka përcaktuar objektivat e punës dhe se i njëjti asnjëherë nuk është ftuar nga udhëheqësi i tij për të diskutuar për rezultatet e arritura dhe progresin në punë siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi. Me tutje ankuesi pretendon se vlerësimi i rezultateve të punës është bërë në kundërshtim me përshkrimin e detyrave të punës të përcaktuar për pozitën të cilën e mban ankuesi.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar legjislacionin në fuqi, dhe rrjedhimisht ka konstatuar se deri me datë 06.10.2020, kriteret dhe procedurat për vlerësimin e rezultateve të punës të nëpunësve civil kanë qenë të përcaktuara me Rregulloren Nr.19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil, ku sipas dispozitave të kësaj rregullore, vlerësimi i rezultateve të punës



bazohet në matjen e realizimit të objektivave dhe aftësive të nëpunësit civil, sipas planit individual vjetor të punës dhe përshkrimit të detyrave të punës se tij.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se nuk janë përcaktuar paraprakisht objektivat e punës, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit për periudhën e vlerësimit nuk ka përcaktuar objektivat, respektivisht nuk është përgatit planin individual vjetor siç përcaktohet me nenin 5 paragrafi 2 të Rregullores Nr.19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil. Po ashtu në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi se udhëheqësi i drejtpërdrejtë gjatë periudhës vlerësuese ka zhvilluar takime me nëpunësin për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të përcaktuara dhe sjelljet profesionale si dhe për dhënien e sugjerime për përmirësime të nevojshme, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i bazuar.

Bazuar në përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e Zyrtarit të Lartë për Hulumtime është konstatuar se qëllimi i kësaj pozite të punës është *Hulumtimi i rasteve të procesimit dhe personalizimit të letërnjoftimeve, pasaportave dhe patentë shofereve*. Ndërsa bazuar në formularin e vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2020 Kolegji ka gjetur se ankuesi është vlerësuar për arritjen e objektivave për procesimin e të dhënave për letërnjoftime, verifikimin e të dhënave para procesimit për letërnjoftime dhe verifikimin e të dhënave para procesimit për pasaporta, ndërsa i njëjti nuk është vlerësuar për hetimin dhe zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me procesimin e letërnjoftime, pasaporta dhe patën shoferët e cila është një nderë detyrat kryesore sipas përshkrimit të vendit të punës të ankuesit. Andaj, në këtë kuptim Kolegji konstaton se vlerësimi i arritjes së objektivave për vitin 2020 për ankuesin është bërë në kundërshtim me përshkrimin e vendit të tij të punës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, po ashtu ka gjetur se vlerësimi i rezultateve të punës për ankuesin është bërë me datë 01.02.2021, në kundërshtim me afatin e përcaktuar me nenin 8 paragrafi 2 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publikë, e cila rregullore ka hyrë në fuqi me datë 06.10.2020.

Andaj, duke marr parasysh të gjeturat si me lartë, bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi për aprovimin e ankesës, anulimin e formularit të vlerësimit të rezultateve të punës të vitit 2020 për ankuesin dhe kthimin e lëndës në rivlerësim të udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit.

Udhëheqësi i Sektorit për Pranimin dhe Verifikimin e të Dhënave në Agjencinë e Regjistrimit Civil, në cilësinë e udhëheqësit të drejtpërdrejtë të ankuesit, me rastin e rivlerësimit obligohet që të marr parasysh të gjeturat dhe të veproje sipas pikëpamjeve juridike të këtij vendimi.


Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.101/2021

Avdyl BEKTESHI



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil;
- Udhëheqësit të Sektorit për Pranimin dhe Verifikimin e të Dhënave;
- Udhëheqësit për Burime Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

